REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE
Njësia org. / Org. Jedinica / Org. Unit: SP-02
Nr. i Faqeve / Br. Stranica / No. Pages: -03-
Nr. i Prot. / Broj Prot. / Prot. No.: 2217-2/22
Data / Datum / Date: 09.02.23
PRISHTINË / A
No. 1

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara /Office of the General Secretary

DATË/A:	03.02.2023
REFERENC-Ë:	22/2217/MMPHI
PËR/ZA/TO:	"Granit" SH.P.K. Istog Thërrmim dhe seperim të gurit gëlqeror ne Dushkajë- Istog
CC:	Komisioni për Leje Mjedisore
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Servet Spahiu, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për Leje Mjedisore

Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), ka shqyrtuar kërkesën për tu pajisur me Leje Mjedisore të operatorit "Granit" SH.P.K. Istog, me Nr. Prot. 22/2217/MMPHI.

MMPHI, pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur, një sërë takimesh dhe vizitës në teren, ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur.

Bashkangjitur kësaj shkrese gjeni :

1. Vendimi për Leje Mjedisore për operatorin "Granit" SH.P.K. Istog, për veprimtarinë: thërrmim dhe seperim të gurit gëlqeror ne Dushkajë- Istog; dhe

2. Shtojcën: Obligimet dhe detyrimet që dalin nga Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Udhëzimi Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.

Me respekt!

Adresa: Objekti i Ri Qeveritar, ish Pallati i Mediave " Rilindja" kati 17, nr: 1713 - 10 000 Prishtinë - Kosovë
Telefon: + 381 38-200-32-307; https://mmphi.rks-gov.net/

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara /Office of the General Secretary

Nr.: 22/2217/MMPHI
Datë: 03.02.2023

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 31 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, paragrafi 1, 2 dhe 4 të nenit 12 dhe nenit 13 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, Vendimit për Pëlqim Mjedisor Nr. 05/2931/1-ZSP-705 të lëshuar me dt. 14.11.2005, si dhe Mendimit Profesional të Komisionit për Leje Mjedisore te dt. 30.01.2023, nxjerr këtë:

VENDIM

1. Operatorit "Granit" SH.P.K. Istog, pajiset me Leje Mjedisore për veprimtarinë: thërrmim dhe seperim i gurit gëlqeror në ngastrën kadastrale nr. 213/5, zona kadastrale Dushkajë- Istog.

2. Operatori obligohet:

   2.1. Të bënë monitorimin e vazhdueshëm të pajisjeve, respektivisht përmbushjes së kërkesave teknike;
   2.2. Vazhdimisht të behët spërkatja me ujë e rrugëve të pa asfaltuara të cilat shfrytëzohen për bartjes të gurit gëlqeror;
   2.3. Sistemi de- pluhurues të jetë funksional;
   2.4. Vlerat e cilësisë së ajrit te seperimi i gurit gëlqeror të jenë në nivelin e lejuar sipas legjislacionit në fuqi;

Adresa: Objekti i Ri Qeveritar, ish Pallati i Mediave " Rilindja" kati 17, nr: 1713 - 10 000 Prishtinë - Kosovë
Telefon: + 381 38-200-32-307; https://mmphi.rks-gov.net/

2.5. Raporti i rezultateve të cilësisë së ajrit të sepërimi i gurit gëlqeror, sipas dinamikes së përcaktuar me legjislacion të i dorëzohet MMPHI-së;
2.6. Për sistemin menaxhues mjedisore të këtë personin e profilit inxhinierik që është përgjegjës për mjedis;
2.7. Pas përfundimit të aktivitetit të behët rehabilitimi i terenit sipas përshkrimit në aplikacion;
2.8. Nëse gjatë operimit do të ketë ndonjë prishje teknike e që mund të ketë ndikim në mjedis dhe shëndetin e popullatës, të njoftoj MMPHI.

Arsyetim

Pas shqyrtimit të kërkesës për Leje Mjedisore për operatorin "Granit" SH.P.K. Istog, është konstatuar se Operatori për veprimtarinë: thërrmim dhe seperim i gurit gëlqeror në ngastrën kadastrale nr. 213/5, zona kadastrale Dushkajë- Istog, plotëson kriteret e parapara me Udhëzim Administrativ 04/2022/MMPHI, për Leje Mjedisore.

Andaj bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, vlerëson se operatori i plotëson kushtet teknike dhe mjedisore dhe merr Vendim për lëshimin e Lejes Mjedisore.

Kjo Leje Mjedisore lëshohet për periudhën 5 (pesë) vjeçare, komfor nenit 31 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtje e Mjedisit dhe nenit 12 paragrafi 4 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Servet Spahiu

Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI-së

Vendimi i 'dërgohet:
- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës- Istog;
- DMMU-së;
- Inspektoratit të MMPHI-së;
- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPHI-së;
- Arkivit të MMPHI-së

Adresa: Objekti i Ri Qeveritar, ish Pallati i Mediave " Rilindja" kati 17, nr: 1713 - 10 000 Prishtinë - Kosovë
Telefon: + 381 38-200-32-307; https://mmphi.rks-gov.net/

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ZHIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE
Njësia org. / Org.Jedinica / Org.Unit: DMMU
Nr.i Faqeve / Br.Stranica / No.Pages: /
Nr.i Prot. / Broj Prot. / Prot. No.: 2217-2/22
Data / Datum / Date: 06. 2. 23
PRISHTINË / A
No. 1

Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Enviroment, Spatial Planning and Infrastructure

Departamenti për Mbrojtjes e Mjedisit dhe Ujërave / Departament za Zaštitu Sredine i Voda / Department of Environment Protection and Waters

REFERENC-Ë:	22/2217/211/MMPHI-DMMU
DATË/A:	03.02.2023
PËR/ZA/TO:	Servet Spahiu, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Ismail Hetemaj, Zëvendësues i Drejtorit të DMMU Visare Istrefi, U.D. Udhëheqëse e DMNI-së
NGA/OD/FROM:	Hana Imeri, kryesuese e komisionit për Leje Mjedisore
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Përgjigje lidhur me Leje Mjedisore për operatorin "Granit" SH.P.K. Istog Thërrmim dhe seperim të gurit gëlqeror ne Dushkajë-Istog

Te nderuar,

Bashkëlidhur gjeni lëndën me nr. Protokolli: nr. prot. 22/2217/211/MMPHI-DMMU, të operatorit "Granit" SH.P.K. Istog, për veprimtarinë: thërrmim dhe seperim të gurit gëlqeror ne Dushkajë- Istog.

Me respekt,

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Departamenti i Mbrojtjes së Mjedisit dhe Ujërave / Departament za Zivotnu Sredinu i Vodu/
Department of Environment Protection and Water

LISTË DISTRIBUIMI/ CIRKULARNO PISMO/ ROUTING SLIP

REFERENC-Ë:		22/2217/211/MMPHI-DMMU			
PËR/ZA/TO:		Servet Spahiu, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI			
CC:					
PËRMES/PREKO/THROUGH:		Ismail Hetemaj, Zëvendësues i Drejtorit të DMMU Visare Istrefi, U.D. Udhëheqëse e DMNI-së			
NGA/OD/FROM:		Komisioni për Leje Mjedisore			
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:		Përgjigje ne kërkesën e operatorit "Granit" SH.P.K. Istog Thërrmim dhe seperim të gurit gëlqeror ne Dushkajë-Istog			
Nr. i zyrës: **Br. kancelarije:** **Room No.:**	1517	**Lokacioni:** **Kucni:** **Extension:**	Ish pallati i mediave Rilindja, Prishtinë.	**Data:** **Datum:** **Date:**	03.02. 2023
PËR AKTIVITET/ZA AKTIVNOST/FOR ACTION					☐
PËR MIRATIM/ZA USVAJANJE/FOR APPROVAL					☒
PËR NËNSHKRIM/ZA POTPIS/FOR SIGNATURE					☒
PËR KOMENTE/ZA KOMENTARE/FOR COMMENTS					☐
A MUND TË DISKUTOJMË/DALI MOZEMO RASPRAVLJATI/MAY ËE DISCUSS					☐
VËMENDJA JUAJ/VASA PAZNJA/YOUR ATTENTION					☐
SIPAS DISKUTIMIT/KAKOJE RASPRAVLJENO/AS DISCUSSED					☒
SIÇ ËSHTË KËRKUAR/KAKO JE ZATRAZENO/AS REQUESTED					☒
SHËNIM DHE PËRGJIGJE/BELESKA I ODGOVOR/NOTE AND RETURN					☒
PËR INFORMIMIN TUAJ/ZA VASU INFORMACIJU/FOR YOUR INFORMATION					☐
AFATI/KRAJNI ROK/DEADLINE					

I nderuari Sekretar,

Komisionit për Leje Mjedisore i emëruar me Vendimin Nr. 83/2022, me nr. prot. 4306/2022, të dt. 01.08.2022, duke u bazuar në nenin 9 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, në afatin e paraparë ligjorë, jep këtë Mendim Profesional:

Operatori "Granit" SH.P.K. Istog, ka aplikuar me Nr. Prot. 22/2217/211/MMPHI-DMMU, për vazhdimin e Lejes Mjedisore me Nr. 16/5235/ZSP/174/17 të lëshuar me dt. 03.07.2017, për veprimtarinë: thërrmim dhe seperim të gurit gëlqeror në ngastrën kadastrale nr. 213/5, zona kadastrale Dushkajë- Istog, sipas Pëlqimit Mjedisor Nr. 05/2931/1-ZSP-705 të lëshuar me dt. 14.11.2005.

Sa i përket dokumentacionit kompania kërkesës për tu pajisur me Leje Mjedisore i ka bashkangjitur dokumentacionin si në vijim:

- Aplikacionin e plotësuar në pesë kopje fizike dhe një kopje elektronike (CD);
- Fletëpagesën, në bazë të Vendimit: Nr. 56, datë 19.11.2015, për përcaktimin e kritereve dhe vlerat e tarifës për shërbimet lidhur me procedurat e shqyrtimit të kërkesave për leje mjedisore;
- Certifikatën e regjistrit të biznesit;
- Pëlqim Mjedisor me Nr. 05/2931/1-ZSP-705 të lëshuar me dt. 14.11.2005;
- Leje Mjedisore me Nr. 16/5235/ZSP/174/17 të lëshuar me dt. 03.07.2017;
- KPMM- Leje për aktivitete të veçanta për seperim, me nr. 640/KPMM/2018, të protokolluar me nr. 3939, të lëshuar me dt. 29.10.2018, me afat të vlefshmërisë deri me dt. 02.09.2023;
- Raport i analizave të pluhurit total të depozituar;
- Kuvendi Komunal Istog- Pëlqim me nr. 08/320-70 të lëshuar me dt. 08.09.2005, për vendosje të Bazës së Asfaltit, Fabrikes së betonit dhe Impiantit të Gurthyesit dhe për aplikim për leje pune pranë institucioneve kompetente.

Komisioni për Leje Mjedisore ka realizuar vizite te operatori, për verifikimin e kushteve mjedisore me dt. 21.10.2022.

Komisioni, pas realizimit te vizitës në teren për shfrytëzimin e gurit gëlqeror ka kërkuar nga operatori, plotësimin e dokumentacionit dhe kushteve te cekura me poshtë:

- Matjet e pluhurit total të depozituar;
- Vendosja e sistemit de- pluhurues gypor dhe me spërkatje te thërrmimi dhe seperimi i gurit gëlqeror.

Operatori, për kushtet e cekura me lartë ka sjell informata shtesë për plotësim te kushteve duke prezantuar edhe foto dëshmi për rregullimin e gjendjes ne teren sipas kërkesës te komisionit për Leje Mjedisore.

Komisioni, pas shqyrtimit të kërkesës te operatorit në fjalë duke përfshirë aplikacionin, dokumentacionin përcjellës qe nevojitet për pajisje me leje mjedisore dhe gjendjes faktike në teren, në takimin e mbajtur me dt. 30.01.2023, në përbërje prej pesë (5) anëtareve, unanimisht, kanë dhen mendim profesional si ne vijim:

Operatori i ka sjellë të gjithë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me Udhëzimin Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, gjithashtu operatori i ka plotësuar të gjitha kushtet teknike dhe mjedisore dhe si përfundim Komisioni rekomandon që ti lëshohet Leja Mjedisore.

Bashkangjitur këtij Mendimi Profesional gjeni edhe propozim vendimin për Leje Mjedisore.

Komisioni:

Hana Imeri, kryesuese _____
Adem Tusha, anëtar _____
Fatmir Bytyqi, anëtar _____
Përparim Terziu, anëtar _____
Lindita Morina, anëtare _____